



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

ZGJEDHJET

Hyrje

Që nga themelimi i tij në vitin 1999, Misioni i OSBE-së ka organizuar dhe mbikëqyrur zgjedhjet në Kosovë. Gjatë dy viteve të kaluara, Misioni ka udhëhequr procesin e bartjes së përgjegjësive të veta që lidhen me zgjedhjet, te autoritetet vendore të zgjedhjeve, kryesisht te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe te Sekretariati i tij, themelimin e të cilëve e ka ndihmuar.

Deri më tani, në Kosovë janë mbajtur katër palë zgjedhje në nivelin komunal në vitet 2000 dhe 2002 dhe në nivelin qendror në vitet 2001 dhe 2004. Të gjitha janë kualifikuar si të lira dhe të drejta, si nga vëzhguesit vendorë, ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë. Trendi i tillë është shumë me rëndësi për zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

Gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e tetorit të vitit 2004, OSBE-ja dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës dhe Sekretariati i tij i kanë zbatuar bashkisht përgjegjësitë operative. Aktivitetet e udhëhequra nga OSBE-ja për krijimin e Listës së votuesve, zhvillimi i Votimit Jashtë Kosovës, si dhe Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve janë planifikuar të bartën në KQZ për ciklin e ardhshëm të zgjedhjeve.

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), krahu operativ i KQZ-së, ka dëshmuar aftësinë e vet për organizimin e zgjedhjeve duke zhvilluar aktivitete të suksesshme në fushën e koordinimit dhe të planifikimit (krijimi i komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe i këshillave të vendotimeve), certifikimi i subjekteve politike, informimi publik, akreditimi i vëzhguesve dhe shpërndarja e materialit të zgjedhjeve.

Deri tani, Misioni ka trajnuar, mentoruar dhe monitoruar SKQZ-në. Ai do të vazhdojë ta bëjë këtë në vitin 2005 dhe të ndërtojë mëtutje kapacitetin e Sekretariatit që funksionon si institucion apolitik shumetnik.

Kryesuesi i Misionit të OSBE-së, Ambasadori Werner Wnendt do të vazhdojë ta kryesojë Komisionin, organ ky i ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve. Misioni shpreson të marrë rol të krejtësisht këshilldhënës në zgjedhjet e ardhshme komunale të parapara për vitin 2006.



Misioni i OSBE-së në Kosovë, Shtylla e Ndërtimit të Institucioneve (Shtylla III) prej katër shtyllave të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), është mandatuar t'i organizojë zgjedhjet dhe të krijojë institucionet vendore të zgjedhjeve që do të merrnin përgjegjësinë për zhvillimin e zgjedhjeve. Dorëzimi i plotë i përgjegjësive operative që lidhen me zgjedhjet nga OSBE-ja tek institucionet vendore parashihet nga viti 2006.

Aktivitetet

Në aktivitetet e Misionit që lidhen me zgjedhjet në vitin 2005 hyjnë mirëmbajtja e Regjistrit të votuesve, udhëheqja e Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, dhe hartimi i legjislacionit të zgjedhjeve.

Regjistri i votuesve

Një listë e votuesve e saktë dhe e azhurnuar është qenësore për zgjedhje gjithëpërfshirëse, të pranuar dhe efikase. Misioni i OSBE-së dhe UNMIK-u vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të përgatitur dhe mirëmbajtur një listë të votuesve të cilësisë së lartë që do të përdoret në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës, si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për dorëzimin e procesit tek SKQZ-ja.

Procesi i nxjerrjes së listës së votuesve me zotësi juridike nga regjistri civil dhe caktimi i tyre nëpër vendvotime aktualisht administrohet nga OSBE-ja. OSBE-ja dhe Zyra e Regjistrimit Civil të UNMIK-ut do të punojnë së bashku për ta thjeshtësuar procesin dhe për ta inkorporuar atë në strukturën ekzistuese të regjistrimit civil të UNMIK-ut. Në të ardhmen, SKQZ-ja do të jetë në gjendje ta marrë listën e votuesve me zotësi juridike drejtpërdrejt nga regjistri civil, pa kurrëfarë ndihmese të mëtejshme nga OSBE-ja.

Regjistrimi i partive politike

Regjistrimi në Zyrën e Regjistrimit të Partive Politike (ZRPP) është kërkesë për çdo parti politike që dëshiron të veprojë në Kosovë. Ajo mban listën e të gjitha partive politike të regjistruara dhe informatat e tyre përkatëse financiare, që kërkohet t'i dorëzojë nga secila parti e regjistruar.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike shërben për dy qëllime:

- promovimin e menaxhimit demokratik të partive politike; dhe
- transparencën në jetën politike të Kosovës.

ZRPP-ja vë në dispozicion për t'u shikuar nga publiku, profilin e plotë dhe të saktë të subjekteve politike dhe veprimtaritë e tyre financiare. Nivele të tilla të qasjes publike janë veçori e qëndrueshme në demokracitë e pjekura, dhe aktivitetet e tilla ndihmojnë në ngritjen e niveleve të njohurive të publikut rreth jetës politike në Kosovë, dhe promovojnë llogaridhënien nga ana e subjekteve politike.

Subjektet politike (gjegjësisht, partitë politike, iniciativat qytetare, kandidatët e pavarur dhe koalicionet) që planifikojnë të marrin pjesë në zgjedhjet në të ardhmen, do të duhet t'i nënshtrohen një procedure të re të certifikimit për atë cikël të zgjedhjeve.

Administrimi i ZRPP-së do t'u dorëzohet institucioneve relevante vendore në pjesën e parë të vitit 2006.

Hartimi i legjislacionit

Misioni do të mbetet aktiv me rolin e tij këshilldhënës në vitet 2005 dhe 2006 duke vazhduar të kontribuojë në hartimin e kornizës legjislative të zgjedhjeve. Ai do të veprojë ashtu duke kontribuar drejtpërsëdrejti në Zyrën e UNMIK-ut për Çështje Juridike duke ofuar ndihë konkrete dhe duke e mentoruar KQZ-në gjatë miratimit të rregullave të zgjedhjeve për zgjedhjet e ardhshme.

Institucionet e zgjedhjeve në Kosovë

Institucionet e vendit kanë marrë gradualisht mbi vete administrimin e procesit zgjedhor. OSBE-ja, sipas mandatit të vet të ndërtimit të institucioneve, është duke punuar për të siguruar qëndrueshmëri të organeve të ngritura për administrimin e zgjedhjeve në Kosovë në nivelin qendror dhe komunal. Në institucionet që do t'i administrojnë të gjitha zgjedhjet e ardhshme

në Kosovë hyjnë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Sekretariati i tij dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/9, është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ-së është që të rregullojë procesin zgjedhor përmes miratimit të rregullave të zgjedhjeve dhe mbikëqyrjes së të gjitha aspekteve të këtij procesi për të siguruar që zgjedhjet t'i përmbushin standardet ndërkombëtare.

Komisioni përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë dhe nëntë anëtarë vendorë të Komisionit. Të gjithë anëtarët emërohen nga PSSP-ja. Tre anëtarë vendorë nominohen nga tri subjektet kryesore politike me numrin më të madh të vendeve në Kuvendin e Kosovës. Katër të tjerët nominohen nga subjektet politike të cilat konkurojnë për njëzet vendet e Kuvendit, të rezervuara për komunitetet jo-shqiptare dhe që kanë fituar numrin më të madh të votave. Komuniteti serb dhe turk i Kosovës nominojnë nga një anëtar secili, anëtari tjetër nominohet nga komunitetet rom, ashkal, egjiptian, dhe një tjetër nga boshnjakët dhe goranët. Dy anëtarët e mbetur janë përfaqësues të sektorit jo-qeveritar të nominuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës.

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ)

SKQZ-ja, i krijuar me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut 2003/28, është krahu operativ i KQZ-së. Ai është një organ shumetnik dhe i rekrutuar në vend, me një strukturë të përhershme dhe të pavarur të shërbimit publik. SKQZ-ja është një organizatë krejtësisht teknike, me mandat jopolitik. Gjatë operacioneve zgjedhjeve të vitit 2004, SKQZ-ja ka qenë përgjegjëse për aktivitetet në fushën e koordinimit dhe të planifikimit, të certifikimit të subjekteve politike dhe të kandidatëve, të informimit publik, të akreditimit të vëzhguesve dhe të shpërndarjes së materialeve të zgjedhjeve. Parashikohet që SKQZ-ja do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha aspekteve operative dhe teknike në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë.

Komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ)

KKZ-të janë organe profesionale të krijuara nga KQZ-ja në secilën nga 30 komunat e Kosovës, për të ndihmuar zhvillimin e zgjedhjeve. KKZ-të përgjigjen për sigurimin e informatave votuesve dhe subjekteve politike përkitazi me të drejtat dhe obligimet e tyre dhe për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve operative në komunat e tyre. Para zgjedhjeve, ato emërojnë dhe trajtojnë këshillat e vendotimeve dhe ndihmojnë për aranzhimet teknike në vendvotime. Nga KKZ-të pritet t'i kryejnë punët e tyre në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke u siguruar të gjithëve nivel të barabartë të shërbimit. Secila KKZ kryesohet nga zyrtari komunal i zgjedhjeve, i cili aktualisht është anëtar i përhershëm i personelit të SKQZ-së. Të gjithë anëtarët tjerë të KKZ-së emërohen përkohësisht nga KQZ-ja gjatë periudhave të zgjedhjeve.

